



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 5/2016**

**PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT NË PYJE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Neni 1

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të reduktojë ndërhyrjet mbi fondin pyjor, të degraduar si pasojë e mbishfrytëzimit dhe dëmtimeve të tjera, me synim përmirësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së tij.

Neni 2

**Objekti dhe fusha e veprimit**

Objekti i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimi i produkteve të tij, ndalimi i eksportit të lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe i qymyrit të drurit.

Neni 3

**Përjashtim nga fusha e zbatimit**

1. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:

a) shfrytëzimi i lëndës drusore për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri;

b) rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor dhe kullësor, referuar legjislacionit në fuqi;

c) shfrytëzimi i lëndës drusore për rigjenerimin, shëndetësimin e pyjeve dhe pastrimin e mbetjeve drusore.

2. Kriteret dhe procedurat për zbatimin e shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për pyjet.

Neni 4

### **Të drejtat për shfrytëzimin e fondit pyjor**

Të drejtat ekzistuese për shfrytëzimin e fondit pyjor publik/privat, të fituara sipas procedurave ligjore në fuqi, pezullohen deri në daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 2, të nenit 3, të këtij ligji, dhe në përfundim të këtij afati ushtrohen vetëm për veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij ligji, sipas dispozitave të rinegociuara të kontratave.

Neni 5

### **Afati i zbatimit**

Afati i zbatimit të këtij ligji është 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6

### **Sanksionet**

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankim në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 7

### **Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit**

Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave dhe bashkitë për zbatimin e këtij ligji.

Neni 8

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2, të nenit 3, të tij.

Neni 9

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**I lir META**

Miratuar në datën 4.2.2016